

K O M E N T

Pershendetje

Ne VKM 953, datë 29.12.2014 Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimin e fundit VKM 652 dt.10.11.2017 ku është shtuar neni 11/1 “Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e shkallës së reduktuar për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese”

E thene ndryshe ky ndryshim është bere ne zbatim te ndryshimit te ligjit te Tvsh-se 71/2017 date 27.04.2017 per tvsh-ne ne fushen e turizmit ku thuhet:

Në nenin 49, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Ndryshimi i VKM-se ne piken 2 te nenit 11/1 thekson:

2. Në përputhje me pikën 1, të këtij neni, me qëllim aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së, personat e tatueshëm, të cilët, përveç veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese, kryejnë edhe veprimtari të tjera, regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit si persona të tatueshëm më vete, duke riorganizuar ose jo veprimtarinë e tyre ekonomike, siç përcaktohet në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.”.

Nga kjo pike del nje problem jo i vogel pasi brenda 3 muajve, ose me sakte brenda dates 20 Shkurt 2018 duhet qe ato subjekte qe perfitojne nga kjo shkalle e reduktuar e tvsh-se **duhet te riorganizohen duke u ndare me vehte.**

Kjo me vehte !!! çfare presupozon ??

1. Shoqeri me vehte me NIPT me vehte , por

- kjo ne disa raste prish disa gjera te tjera qe kane lidhje me historikun, dhe avantazhet qe mund te kete perfituar me ligjin e turizmit.

- ne shume raste prish ekuilibrin pasi nje shoqeri me Nipt me vehte e do hoteli dhe nje shoqeri me Nipt me vehte e do bari dhe restoranti.

Dhe ne keto raste, **mire qe perfiton Tvsh-ne, por çfare humbet** me shpenzimet e shtuara per dy shoqeri te veçanta?

2.Me riorganizim nenkuptohet dhe ndarja e shoqerise egzistuese ne dy pjese, nje shoqeri per hotelin dhe nje shoqeri per bar restorantin.

Edhe me kete dalim te arsyetimi i mesiperm, por ketu shtohet edhe nje problem se shoqeria qe ndahet vleresohet e prishur, dhe Nipti humbet, duke marre shoqerite e reja, Nipte te rinj, dhe qe gjithmone shton problemet me historikun apo lehtesite e fituara.

3.Po restoranti a duhet ndare me vehte

- nje restaurant pjese e hotelit per ushqimin falas brenda paketes akomoduese dhe
- nje restaurant per te tjeret me 20 % tvsh

4. Po pishina a duhet ndare me vehte

- nje pishine pjese e hotelit per pushuesit brenda paketes akomoduese dhe
- nje pishine per te tjeret me 20 % tvsh

5. Po çadrat a duhet ndare me vehte

- çadra si pjese e hotelit per pushuesit brenda paketes akomoduese dhe
- çadra per te tjeret me 20 % tvsh

Gjithashtu ka dhe nje moment shume te paqarte kur thote.

duke riorganizuar ose jo veprimtarinë e tyre ekonomike

kjo **“ose jo”** a presupozon qe eshte ne te drejten e subjektit te zgjedhe?

Kush e gjen kete kuic?

Nga gjithçka e trajtuar me siper natyreshem lindin pyetjet e meposhteme:

1.Ky ndryshim ligjor u be

- per ta ndihmuar sektorin e hotelerise apo per ta renduar?
- per te fituar nga ulja e tvsh-se apo per te humbur?

2.Po interesi i shtetit ku eshte ketu, se interesi i biznesit dukshem mungon

“Zgjidhja me e mire” (me doza humori)

- **Per ata qe e realizojne ndarjen hallall**
- **Per ata qe nuk e realizojne dot ndarjen “te vazhdojne me tvsh 20%”**
 - a) **Nuk te thote kush gje dhe**
 - b) **Duke punuar me çmim me te larte hyn ose ne uljen e fitimeve ose ne faliment**

Zgjidhjen e sakte e gjen çdokush sipas rastit konkret por e pergjitheshmja eshte se nuk te le shije te mire.